

**SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2 SH.P.K.**  
Rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 1, Apartamenti 3, ZK. Nr. 8160, Tirane, Shqipëri,  
NUIS M12107031P

---

**VENDIM**  
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË**

Sot, me 14.01.2022 në selinë e Shoqërisë Albanian Energy Supplier 2 Sh.p.k. (më tej referuar si "Shoqëria"), në datën u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë me të pranishëm:

**Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën: Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k. (këtu e në vijim referuar si "*Ortaku i Vetëm*").

Znj. Edlira Muka, e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton Znj. Migena Kolonja, e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakut të Vetëm për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, pavarësisht mungesës së njoftimit për thirrjen e asamblesë, e deklaroi Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit n. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim:

**RENDI I DITËS**

- I. MIRATIMI I MARRËVESHJES PËR NDALIMIN E TRANSFERIMIT TË KUOTËS SË SHOQËRISË E CILA LIDHET MES ORTAKUT TË VETËM DHE SHOQËRISË YILDIRIM ALBANIA MINING INVESTMENT SH.P.K.;**
- II. TË NDRYSHME.**

Pas një diskutimi të gjerë, Asambleja e Ortakëve e Shoqërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ndalimin për transferimin e kuotës së Shoqërisë në përputhje me përcaktimet e Marrëveshjes për Ndalimin e Transferimit të Kuotës së Shoqërisë e cila do të lidhet mes Ortakut të Vetëm dhe shoqërisë Yildirim Albania Mining Investment Sh.p.k.;
2. Të autorizojë Administratorin e Shoqërisë, Z. Bers Hado, i cili vetë apo nëpërmjet autorizimit të personave të tjerë, të depozitojë në regjistrin tregtar Marrëveshjen për Ndalimin e Transferimit të Kuotës së Shoqërisë dhe të ndërmarrë të gjitha hapat apo veprimet e nevojshme apo të kërkueshme për këtë regjistrim.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur.

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E SHOQËRISË**  
**ALBCHROME HOLDING SH.P.K.**

**KRYETARI**

  
Znj. Edlira MUKA  
**BALFIN**  
BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP  
**BALFIN sh.p.k.**  
Rruga "Papa Gjon Pali II",  
ABA Business Center, Kati 11, Tiranë  
Nipt: K72223031K

**SEKRETARI**

  
Znj. Migena Kolonja